



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 14, datë 30.09 2021

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR,
SHFRYTËZIM TË MATERIALEVE INERTE OË NXIRREN NGA
SHTRETËRIT E LUMENJVE , PËRRENJVE E LIOENEVE ME
OSE PA UJË , SUBJEKTIT "4 A-M" SH.P.K**

Në mbështetje të shkronjës të pikës 2 të nenit 50 , të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar , vendimit nr.550 datë, 15.07.2020 “*“Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”*”, si dhe Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit me nr.1 prot., datë 7.7.2011, të ndryshuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit nr.2 prot., datë 27.7.2012, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor MAT

V E N D O S I

1. Miratimin e lejes “ Për shfrytëzimin të materialeve inerte” subjektit “4 A-M” SH.P.K. me vendndodhje, në shtratin e lumit Mat, Bashkia Lezhë, sipas këtyre koordinatave në sistemin KRRGJSH:
2. Treguesit paraprak të shfrytëzimit janë:

Zona e shfrytëzimit

X = 474287.06	Y = 4616412.54	Z = 7.4 m
X = 474229.66	Y = 4616231.94	Z = 7.6 m

X = 473654.56
X = 473742.46

Y = 4616482.54
Y = 4616636.54

Z = 5.8 m
Z = 5.7 m

3. Sasia e dhënë në përdorim për të gjithë periudhën e lejes është 85,000 m³;
4. Subjekti të respektojë të gjitha sygjërimet e dhena nga AKM-ja dhe SHGJSH-ja;
5. Subjekti duhet të raportojë çdo muaj pranë ZABU Mat-Ishëm-Erzen për volumin e materialit të nxjerr nga shtrati;
6. Të ndiqet nga ZABU Mat-Ishëm-Erzen zbatimi i projektit të rehabilitimit;
7. Të mos depozitohet material stok në brigjet e shtratit pas përfundimit të kësaj leje;
8. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJOKË JAKU

